

Arkitektura si shprehje politike/ Pasqyrimi i identitetit kombëtar në ndërtesat e ambasadave/ Përvoja e Berlinit

*Teuta Jashari-Kajtazi**

Përmbledhje

Nuk duhet anashkaluar fakti se pas rënies së “Murit të Berlinit”, ai u bë një lokacion me kritika të ndryshme dhe me serë mundësish në fushën e dizajnit dhe arkitekturës, kryesisht në arkitekturën diplomatike e cila pati dhe akoma do të ketë një mundësi për të simbolizuar qartë secilin komb. Ajo çka mund të dallohet në kuadër të këtij studimi është fakti se një grup i kombeve janë në gjendje të përshtaten me qasjet dhe konceptet bashkëkohore, më konkretisht çfarë ka nevojë bota/toka për momentin dhe mënyrën se si të tjerët e tregojnë fuqinë e tyre me anë të ndërtimit të këtyre fortifikimeve (kjo e fundit nuk mund as të quhet fuqi, por mënyrë për t’u mbrojtur nga të tjerët). Për fat të keq duket se arkitektura do të gjendet gjithmonë në dilemën se çfarë bëhet dhe çfarë do të mund të bëhej.

Si rezultat, analiza e objekteve të studimit tregon përfaqësimin e një shteti, vendi apo rajoni në kontekstin e arkitekturës, megjithatë mund të dallohet se këto struktura shkojnë në drejtime të ndryshme ose më mirë të themi, mundohen të shprehin botëkuptime të ndryshme se si duhet të përfaqësohen konkretisht në këtë mjedis dhe çfarë përbën (Kombi) interes më të madh për ta.

Fjalë kyç: *fortifikime bashkëkohore, hapja ndaj publikut, ndërtesa jo-konvencionale, arkitektura dekonstruktive, përfaqësimi i rajonit, kriza e identitetit, identiteti kolektiv, kujdesi ndaj mjedisit.*

Hyrje

Arkitektura e ndërtesave të ambasadave është ose duhet të jetë patjetër ajo arkitekturë e cila paraqet identitetin e një kombi në sytë e botës dhe assesi nuk duhet të keqkuptohet. Nga ana tjetër, ky pohim

* *Teuta Jashari-Kajtazi, Phd Cand. Universiteti AAB, e-mail: teuta.jashari-kajtazi@aab-edu.net*

ngre çështjen nëse ambasadat duhet të jenë fortesa, vende kulturore apo thjeshtë zyra.

Në këtë kontekst është mjaft e rëndësishme të kemi parasysh faktin se këto struktura janë domethënëse në të dy rastet, si simbole nga njëra anë dhe funksionale për njerëzit që punojnë në to nga ana tjetër.

Një pjesë e dizajnit shërben për të kuptuar historikun e të kaluarës duke treguar respekt për kulturën si përfaqësuese e një kombi të caktuar, por duke mos anashkaluar traditën e ndërtimeve vendore, bashkëpunimin me kulturën dhe arkitekturën vendase. Më së miri, Ambasadat duhet të bëhen një zë për një përfshirje më të ngushtë mes dy kulturave.

Arkitektura si çdo pjesë tjetër e artit shërben për të shprehur dhe mbajtur në lëvizje zhvillimet në botë si dhe duke u kujdesur për identitetin e strukturës që është për ndërtim.

Identiteti si tematikë ka disa qasje, por më e rëndësishme është që të bëhen përpjekjet dhe të gjendet ky identitet në arkitekturë si edhe në të gjitha strukturat e tjera të saja. Identiteti në përgjithësi përkufizohet si: individualitet apo diçka me të cilën dallon një individ, ndërsa, sa i përket ndërtesës apo objektit, ata kanë “detajin” si fragment. Kur të gjithë këto detaje vendosen së bashku formohen kompozime të cilat ndihmojnë që të identifikohet lehtësisht një person apo një gjë me këtë të fundit.

Strukturat e identifikuar brenda kësaj analize kanë gjithashtu karakteristikat e veta, ato përfaqësojnë identitetin për secilin komb në botën bashkëkohore, ku secila prej tyre çdo ditë po shkon drejt globalizimit.¹ Ekzistojnë mundësitë e mëdha që shumë shpejt ndërtesat diplomatike mund të mbeten alternativa e vetme në të cilën kombet do të mund të përfaqësohen me anë të arkitekturës dhe dizajnit.

Megjithatë, identiteti si komb shihet në disa sfera të ndryshme, kështu nga këndvështrimi im brenda kësaj arkitekture (diplomatike) dhe kësaj analize të veçantë, do të jenë në fokus “identitetet” e mëposhtme: identiteti kombëtar, identiteti kolektiv dhe një lloj

¹ Bernard Tschumi, Irene Cheng, *The State of Architecture at the beginning of the 21st Century*, Columbia Books of Architecture 2003, faqe.77.

identiteti rajonal, nëse mund të quhet i tillë, do të jetë po ashtu i pranishëm.

Në mënyrë që të gjendet një balancë mbi atë se çka ndërtesat e ambasadave duhet të përfaqësojnë, autori i famshëm Jonathan Glancey,² i njohur në fushën e arkitekturës dhe dizajnit, nga një artikull nga “The Guardian” mbi diplomacinë arkitekturale citon:

“Ndërtesa e një ambasadë është një ambasador për vendin që përfaqëson. Teorikisht ajo duhet të jetë e këndshme, etike dhe mikpritëse. Ajo duhet të ofrojë diçka nga kultura e vendit dhe ndërkohë duke përshëndetur në mënyrë vlerësuese atë të vendit pritës. S’ka përse të jetë vetëm e “modës së vjetër” por as edhe të tentojë të jetë tepër ‘moderne’. Moda kalimtare është thjesht e tillë”.³

Berlini (**fig. 1**), i njohur edhe si qyteti i ndarë për një periudhë kohe dhe kryeqyteti i një vendi të ribashkuar që nga 1990, kaloi nëpërmjet një “kapitulli shtesë” në dizajn dhe ndërtimtari. Duke pasur rolin e kryeqendrës, ai i ka dhënë formë fuqishëm zhvillimeve të fundit në qytet, qeverisë së re dhe distriktit të ambasadës me ndërtime të qeverisë federale; ndërtesave të reja dhe të rinovuara të ambasadës, ndërtesave përfaqësuese të shteteve federale, institucioneve dhe organizatave. Lehtësisht mund të thuhet se ky është qyteti i eksperimentimeve sociale dhe arkitekturale, veçanërisht pas rënies së “ Murit” të Berlinit.

² Jonathan Glancey është redaktor i arkitekturës dhe projektimit në “the Guardian”. Ai është autor i disa librave, të tilla si: Arkitekturë e re në Britani(1988) dhe Teknologjia reja (1994) dhe ai gjithashtu shfaqet rregullisht në televizionin kombëtar dhe radio.

³ Jonathan Glancey, “The Architecture of Diplomacy”, *The Guardian* 09/01/20019.



(1)

Një numër i madh i ndërtesave të ambasadave dhe ndërtesave të tjera përfaqësuese i janë shtuar garës urbane të Berlinit në vitet e fundit, një lloj konkursi brenda arkitekturës bashkëkohore me stilet personale dhe identitetet e ndryshme të saja. Ndërtesat e reja të ambasadave shpalosin varietete të larmishme në stil, në veçanti stile të elementeve rajonal me materialet e ndërtimit të cilat luajnë një rol të fuqishëm në arkitekturën e tyre.

Analizë/Objektet e studimit

Me anë të këtij studimi apo analize dalin katër çështje apo tematika për shqyrtim lidhur edhe me diversitetin në disa qasje (të ndryshme nga njëra tjetra) po të së njëjtës detyrë, pra dizajnimin dhe ndërtimin i ambasadave në Berlin, duke përfshirë kështu një lloj identiteti të caktuar:

- Kriza e identitetit nëpërmjet ndërtesës së Ambasadës së Shteteve të Bashkuara,
- Identiteti kolektiv nëpërmjet ndërtesës së Ambasadës së Holandës,
- Përfaqësimi i identitetit të rajonit (i ashtuquajturit identiteti rajonal) nëpërmjet komplekseve të ambasadave nordike, dhe
- Kujdesi ndaj mjedisit (si ai natyror dhe njerëzor) nëpërmjet ndërtesës së Ambasadës Kanadeze.

Ambasada e Shteteve të Bashkuara

Pasi kaloi nëpër të ashtuquajturën krizë e identitetit të ambasadave Amerikane jashtë vendit, në të cilën çështja e sigurimit ndryshoi pothuajse çdo aspekt të arkitekturës së tyre, ndërtesa e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Berlin vazhdoi me të njëjtën traditë, duke dashur të tregonte “Fuqinë e Uashingtonit”⁴ (fig. 2) në vendndodhjen e mëparshme të “Murit të Berlinit”. Pasi skela u hoq nga fasada, u shfaqën elementë të fortë debati mbi arkitekturën. Një nga arsyet ishte rikujtimi që patën nga negociatat e zgjata dhe tronditëse të berlinasve mbi zonën e sigurisë dhe qarkullimit të trafikut (fig. 3).



(2)



(3)

Ndërtesa e dizajnuar nga firma kaliforniane, Moore Ruble Yudell (fituar në 1996) pati ndërlikime veçanërisht pas disa sulmeve që iu

⁴ Fuqia; në sensin e ndikimit në fushën e ekonomisë globale, politike dhe ushtarake .

bënë ambasadave të Shteteve të Bashkuara jashtë vendit dhe nga vendimi i qeverisë për të forcuar rregullat e sigurisë.⁵ Në mënyrë që të përqafoheshin të gjitha këto aspekte: pra vendndodhja arkitekturale, sigurimi si dhe programi i kërkesave (**fig. 4**); arkitektëve iu desh të punonin ngushtë jo vetëm me Departamentin e Shtetit por gjithashtu edhe me autoritetet e Planifikimit Hapësinor në Berlin. Ndërtesa e re përmbyll fasadën e fundit të Pariser Platz,⁶ me muret e saj të jashtme prej guri, dritaret e rregullta me një ritëm modular, si dhe forma të mëdha skulpturore në çdo anë të saj. Vetë hyrja duket e ndriçuar dhe e qelqtë (**fig. 5**) krahasuar me pjesën tjetër të ndërtesës, duke dashur të japë pamje sa më mikpritëse për vizitorët. Ndërsa brenda pavijonit, oborri ka pamjen e një kopshti zyrtar (**fig. 6**) dhe me tutje duket holli me vepra të artit nga artisti amerikan Sol Lewitt⁷ (**fig. 7**).



(4)

⁵ Rregullat e sigurisë të njohura si standarde Inman, në vend ,që nga viti 1985; Barbara A. Nadel; "Global Diplomacy and Design: Security at U.S. Embassies";

<http://www.buildings.com/article-details/articleid/5784/title/global-diplomacy-and-design-security-at-u-s-embassies.aspx>

⁶ Michael Imhof Verlag, Berlin – *New Architecture – A guide to new buildings from 1989 to today*, 8th updated edition, Taschen, 2008, faqe.42.

⁷ Sol LeWitt ishte një artist amerikan, konceptualist dhe minimalist, i cili u bë i njohur në vitet 1960 me vizatimet e tij murale dhe skulptura (ai i quan ato struktura). Puna e tij e artit në këtë rast mund të konsiderohet si pjesë monumentale në natyrë (pa titull).

<http://www.sollewittprints.org/biography>



(5)

Megjithatë, qëllimi i firmës fituese ishte të kompletonte arkitekturën e sheshit, si dhe të përfshinte elemente artistike dhe arkitekturale që do mund ta transformonte atë në “unike” amerikane.⁸ Ekziston edhe një citat nga Kushtetuta, e skalitur në gurët e mureve të rrumbullakët në hyrje. E ashtuquajtura Kupolla (në disa raste është identifikuar edhe si fanar/lanterne) në katin e sipërm (**fig. 8**) e cila nuk është edhe aq ekspresive sa Kupolla e Reichstag-ut, por gjithsesi është menduar të jetë simboli i pranisë së Qeverisë së Shteteve të Bashkuara në tokën e huaj.



(6)

⁸ Amerika si komb: me të ardhmen e orientuar, krenarë për arritjet e saj artistike dhe teknologjike, të identifikuar me hapjen e demokracisë. Para 1960 siguria nuk ishte konsideruar si një kufizim i projektimit: muret prej qelqi të ndërtesave diplomatike, qasje në trotuar drejtë bibliotekave dhe zonave me ekspozitë (në Romë, Pragë, Paris).



(7)

Edhe pse dizajni dhe procesi i plotësimit kaloi nëpërmjet disa debateve dhe diskutimeve, ambasadori i SHBA-së, Coats, u përpoq të finalizonte të gjithë procesin me fjalët mikpritëse:

“Ambasada është simbol i pranisë së një kombi të huaj, identitetit dhe qëllimeve diplomatike. Nënkupton më tepër se një grumbullim të zyrave të qeverisë. Ne duam që ambasadat tona të përcjellin mesazhin e çiltërsisë dhe optimizmit, projektimin e vlerave demokratike dhe lirisë të cilat udhëheqin diplomacinë tonë. Ne u ndjemë të fortë pasi që të ndërtohet në një vend të largët do mund të përcillej mesazhi i gabuar. Ne planifikuar të ndërtojmë një ndërtesë të bukur këtu në Pariser Platz, e cila do të përshtatej me arkitekturën e këtij vendi aq historik, por gjithashtu do të pasqyronte edhe vetë Amerikën. Besoj se arkitektët janë treguar të suksesshëm në paraqitjen e ndërtesës me idealet e “diversitetit”, “çiltërsisë” dhe “barazisë”. Po në të njëjtën kohë duke u përballur me të gjitha çështjet e sigurisë.⁹ (fig. 9) (fig. 10).

Megjithatë, siç bëjnë të gjitha veprat e artit dhe ato të arkitekturës, edhe kjo jep mundësinë për komente të mëtutjeshme, shprehje dhe mendime analitike, posaçërisht duke pasur parasysh që kjo strukturë lokalizohet në atë zonë të qytetit e cila karakterizohet nga një histori e gjatë dhe si rezultat do të vazhdojë të vizitohet gjithnjë.

⁹ Fjalimi i Ambasadorit Coats, Press Conference U.S. Embassy Berlin, May 5, 2004. <http://germany.usembassy.gov/germany/sp20040506.html>



(8)



(9)



(10)

Nga të gjithë elementet e lartpërmendur, është më se e qartë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës po shkojnë drejt një krize identiteti (duke nënkuptuar përfaqësimin e tyre diplomatik në këtë rast specifik), si rezultat i një numri të madh sulmesh mbi ndërtesat e ambasadave të tyre në të gjithë botën, dhe duke e përfaqësuar veten e tyre si fortifikime të përkohshme në krahasim me atë çka “përpara” ata patën përfaqësuar (përfaqimi i demokracisë). “Përpara” nënkupton kohën përpara viteve 60’, kur këto ndërtime ishin më tepër vende grumbullimi dhe qendra qytetare.

Së fundmi, mund të thuhet se Ambasada e SHBA-së në Berlin është një ndërtesë e cila luftoi shumë derisa arriti formën e saj përfundimtare, e cila u mundua të vendoste një lloj balance apo kompromisi ndërmjet arkitekturës dhe masave të përforcuara të

sigurisë, duke u kujdesur njëherazi edhe për mjedisin ekzistues pranë monumentit me të cilin njihej Berlioni.

Ambasada e Holandës

Në dallim me çfarë Ambasada e Shteteve të Bashkuara kishte lënë përshtypjen se si të dukej, ndërtesa e Ambasadës së Holandës shfaqej e lexueshme transparente dhe mund të konsiderohej lehtësisht si më e dallueshme. Që kur, Holanda kishte shitur tashmë ndërtesën e Ambasadës së mëparshme, vendndodhja e re duhej të bëhej në një vend të përshtatshëm përgjatë lumit Spree.¹⁰ Përshtypja e parë që mund të linte pamja ishte anësorja e kanalit gjerman, gati për të vendosur një ndërtesë përgjatë tij (**fig.11**) (**fig. 12**).



(11)



(12)

¹⁰ Në vitin 1994 u gjet vendndodhja e re, edhe pse ishte ende e paqartë nëse pronësia nuk ka ndonjë mosmarrëveshje pas Luftës 2 Botërore apo edhe nga ish DDR. Megjithatë, çdo gjë shkoi si duhet dhe lokacioni i zgjedhur mund të shfrytëzohej pa asnjë problem.

Ajo është dizajnuar nga arkitekti i famshëm Rem Koolhaas (Zyra e Arkitekturës Metropolitan/ OMA),¹¹ i cili fitoi çmimin “Arkitektura e Berlinit” për këtë strukturë në vitin 2003. Është mjaft me interes të ceket se Koolhaas është i vetmi që nuk ra dakord me planet rindërtuese të Berlinit, duke i konsideruar ato shumë tradicionale, por nga ana tjetër dhuroi një projekt duke pasur shansin që më në fund të linte gjurmët e tij në këtë qytet pas pothuajse 10 vitesh.

Në këtë rast, i vetmi element që tregon në një farë mase identitetin holandez është vendndodhja e zgjedhur për ndërtesën (të lartpërmendur tashmë), por nga ana tjetër ajo tregon më tepër identitetin e vetë arkitektit, thjeshtë nga fakti se ai më në fund i tregoi Berlinit kuptimin e vërtetë i të mos qenurit “tradicional”, çfarë realisht ai mendoi 10 vite më parë.

Duke qenë fragment i arkitekturës dekonstruktive, dizajni i tij përfaqëson pozicionin e lirë të çelikut (**fig.13**) dhe kubikët e qelqit me faqe të barabarta, recepsioni në oborr me distancë të njëjtë nga të gjitha anët nga ndërtesat fqinje, distancë kjo që lejon të soditesh një pamje panoramike nga lumi. Vetë ndërtesa është kombinim i detajeve të ftohta në eksterier si dhe atyre të ngrohta në enterier. I vetmi problem që kjo ndërtesë ndeshi (nëse mund të konsiderohet si i tillë) apo u diskutua rreth saj në krahasim me ndërtesën e Ambasadës së ShBA-së , ishte “sfida” për kompanitë gjermane të ndërtimit të punësuar për projektin, duke qenë ai jo-konvencional (**fig. 14**). Së pari, ajo u dizajnuar pa dyer të brendshme, por duke qenë një ndërtesë ambassade me specifikat e saj, dyert u shtuan me një dizajn special nga Koolhaas. Në total iu shtuan 400 dyer.

Një detaj tejet interesant i cili tregon një tendencë drejt “dekonstruksionit” gjatë dizajnit është koncepti i një trajektoreje e projektuar nga ana e pasme e Kulles (përgjatë kubit) drejt lumit, qëllimi kryesor i të cilit ishte që ndërtesa të dukej sa më transparente që të ishte e mundur.

¹¹ Michael Fazio, Marian Moffet, Lawrence Wodehouse, *A World History of Architecture*, Second Edition, London, Laurence King Publishing 2008, faqe.532.



(13)



(14)


Pas kompletimit të saj, e dizajnuar nga një ndër arkitektët më të famshëm, ndërtesa u bë aq e popullarizuar sa që holli i saj u la gjithnjë i hapur për vizitorët, duke pasur nën dispozicionin e tyre udhërrëfyes turistikë që shpjegojnë detajet më interesante arkitekturale (fig.15) dhe të vendosura, këto të gjitha së bashku tregojnë në mënyrë të qartë identitetin e një arkitekti / grupeve të dizajnit (në këtë rast Rem Koolhaas dhe OMA). Kjo mund të shihet edhe si identitet kolektiv me anë të cilit arkitekti / dizajneri kompletion një pjesë të identitetit të tij personal.¹² Duket qartë se holandezet donin një ndërtesë autonome, të vetme, dhe mjaft të perceptueshme me mundësinë që të kthehej në një rast evenimenti.¹³

Nga kjo pikëpamje, ata arritën të dizajnonin një strukturë që dëshmonte transparencë, jo vetëm në aspektin e formës dhe

¹² Christoph Weller, *Collective Identities in World Society Some Theoretical and Conceptual Considerations*, World Society Research Group, June 1997, faqe.34.

¹³ Rem Koolhaas, Francois Chaslin, *The Dutch Embassy in Berlin by OMA/ Rem Koolhaas*, Rotterdam NAI Publishers, 2004, faqe.28.

përshkrimit gjeometrik të saj, por gjithashtu në aspektin e manifestimit të modernitetit dhe çiltërsisë e cila supozohet të karakterizojë Holandën.¹⁴ Kjo doli nga fakti se deri në fund të shekullit XX, holandezët nuk kishin një traditë të dallueshme në dizajn dhe ndërtim të ndërtesave jashtë vendit. Ndërkohë, kjo tregon fillësën e kontributit të Rem Koolhaas (OMA), për të shprehur qëndrimet aq sa ishte e mundur, duke nxjerrë kështu në pah identitetin e tij personal arkitektonik.



(15)

Kompleksi i ambasadave të vendeve nordike

Vendet nordike si (Suedia, Danimarka, Finlanda, Norvegjia dhe Islanda) kanë ndërtuar ambasadat e tyre në një kompleks (**fig. 16**). Të gjitha i kanë ndërtesat e ndara përveç zonës së receptionit dhe qendrës së informacionit të njohur si “Felleshuset” ose “House for

¹⁴ Ibid., faqe.131.

All'' (fig. 17). Dizajni vjen nga ortakëria Austro-Finlandeze e Alfred Berger dhe Tiina Parkkinen; duke shikuar gjeometrinë e kompleksit nga lart, duket sikur ndërtesat janë gdhendur nga një bllok i vetëm. Një tjetër detaj i cili paraqet përshtypjen skandinave/ nordike dhe lidhjen ujore mes këtyre vendeve është kombinimi i pishinave të ulëta të cilat hasin të pesë ambasadat (fig.18), ndërsa elementi bashkues i të gjithë kompleksit është muri karakteristik si një rrjetë bakri i bërë me frëngji ajrimi (fig. 19).



(16)



(17)

Është me rëndësi të ceket se të gjithë materialet e përdorura për ndërtimtari janë tipike nga rajoni i veriut, duke pasur gjithashtu parasysh se bashkuesi ideal për gurët natyrorë, drurin dhe qelqin është çeliku i pandryshkshëm i cili përdoret kryesisht për lidhjen, montimin dhe inkuadrimin e fasadave të ndryshme. Ky kombinim i tillë jep përshtypjen e një atmosfere të qetë dhe miqësore në të gjithë kompleksin.



(18)



(19)

Nga çka u tha më sipër, është më se e qartë se qëllimi kryesor i dizajnit është që të shprehë shpirtin nordik nëpërmjet formave të jashtme dhe të brendshme si dhe materialeve të përdorura në ndërtimtari. I ashtuquajturi “ *Stili i ndritshëm dhe i kthjellët Skandinav*” (fig.20) karakterizohet nga kompozicione të qarta, efekti blu-gjelbër i xhamit, çimentoja gri e ekspozuar, tone të ngrohta të drurit, çeliku i shndritshëm i pandryshkshëm, rrafshi i brendshëm, orenditë dhe pajisjet e thjeshta. Çfarë ato mundohen të tregojnë brenda këtij kompleksi (i shprehur me anë të arkitekturës), është ruajtja e mjedisit dhe natyrës si karakteristike e rëndësishme e vendeve Nordike.¹⁵

¹⁵ Duane Phillips, Alexandra Geyer, *Berlin – A guide to recent architecture*, London, Anova books Company, 2003, faqe.94.



(20)

Ambasada e Kanadasë

Brenda këtij konteksti Ambasada e re e Kanadasë (**fig.21**) e dizajnuar nga firma të ndryshme të arkitekturës nga Toronto, Quebec, Winnipeg arriti të tregojë një interesim të madh në zhvillimet e qëndrueshme (projektimi që ka ndikim të pakët negativ në mjedis, teorikisht që s'ka ndikim fare në ambient).¹⁶ Duke u bazuar në rregulloren e Planifikimit të Berlinit, e cila ka si qëllim uljen e shpenzimeve të energjisë elektrike dhe ndotjes së ajrit, dizajnesit erdhën me idenë e të pasurit një çati të “gjelbër”. Kjo zonë e dizajnuar nga një ndër arkitektët më të mirë Kanadez të peizazhit, Cornelia Oberlander, mbulon rreth 60% të të gjithë zonës së çatisë duke ulur në këtë mënyrë nxehësinë urbane dhe duke absorbuar ujin e shiut, duke e lejuar atë të kondensohet ngadalë në atmosferë.

¹⁶Michael Fazio, Marian Moffet, Lawrence Wodehouse, *A World History of Architecture*, Second Edition, London, Laurence King Publishing 2008, faqe.560.



(21)



(22)


Përveç çatisë, karakteristika të tjera për ruajtjen e energjisë janë integruar brenda ndërtesës, si psh: dizajni i brendshëm i cili maksimizon depërtimin e dritës natyrale dhe minimizon përdorimin e dritës artificiale, ventilimi natyror që bëhet me anë të dritareve të cilat hapen mekanikisht, sensorët e dritës të cilët automatikisht shuajnë dritën artificiale atëherë kur arrihet niveli i kërkuar i dritës natyrale. Të gjitha këto karakteristika të qëndrueshme janë të inkuorporuar në mjedisin ekzistues (fig. 22).

Çfarë realisht e tregon identitetin dhe gjeografinë e Kanadasë është përdorimi i një sërë materialeve nga rajone të ndryshme të saj: guri gëlqeror i Tyndall-it nga Manitoba i përdorur për fasadat e përparme; graniti i zi dhe druri panje që vijnë nga Quebec-u dhe mermeri Eramoza nga Ontario, kur vendosen të gjitha së bashku krijojnë hapësira të brendshme mbresëlënëse. Të gjitha materialet dhe sistemet mekanike janë zgjedhur sipas kriterit të jetëgjatësisë. Përdorimi i materialeve kryesisht të sjella nga vendasit duhet të jenë pjesë e përfaqësimit të identitetit nga njëra anë si dhe inkuorporimin e tyre në mjedisin ekzistues nga ana tjetër, e cila është mjaft e evidente në rastin e Kanadasë.

Një fakt tjetër i rëndësishëm lidhur me Ambasadën e re të Kanadasë është edhe “Udhë-kalimi Veriperëndimor” (fig. 23) për kalimtarët brenda ndërtesës, të cilët lejojnë jo vetëm klientët por edhe njerëz të tjerë të cilët kalojnë çdo ditë nga Lindja e Vjetër deri në Perëndim të Berlinit dhe anasjelltas. Ky shteg gjithashtu të ofron një “dritare” për në Kanada me anë të veprave të integruara të artit (bazuar në motivet e peizazhit Kanadez dhe krijuar nga produktet e ndërtimit nga natyra e Kanadasë) (fig. 24).¹⁷



(23)



(24)

¹⁷ "Lumi si fije, kanoe si gjilpërë", vepër e artit projektuar nga John McEwen, një nga artistët kryesorë Kanadez. Canoe ka një hartë të gdhendur te rrugëve kryesore ujore kanadeze. http://www.canadainternational.gc.ca/germany-allemagne/offices-bureaux/embassy_art_ambassade.aspx?lang=eng

Fjalët në vijim të Ambasadorit të Kanadasë Paul Dubois mundohen të japin mesazhin maksimal të qasjes ndaj publikut:

“Ndërtesat e zyrave tona të reja mundësojnë një gamë të gjerë të shërbimeve të Qeverisë Kanadeze për klientët jashtë vendit, përfshirë këtu shërbimin konsullor dhe atë të vizave. Ambasada e re ofron ambiente publike me objekte multimediale duke paraqitur arritjet e kanadezëve në krijimin e një shoqërie të larmishme ku biznesi, shkenca, teknologjia dhe arti lulëzojnë së bashku (fig. 25) (fig. 26).¹⁸ Kanada House është shtëpia juaj në kryeqendrën e shtetit më të madh në Bashkimin Evropian. Po ju ftoj të klikoni mënyrën tuaj përmes karakteristikave dhe motiveve të ndryshme në marrëdhënien Kanada-Gjermani dhe të na vizitoni kur të gjendeni afër Berlinit”.

Vërehet mjaft qartë se kanadezët më shumë se çdo komb tjetër, duke qenë pjesë e këtij angazhimi, mundohen të përputhen me mjedisin dhe kulturën ekzistuese sa më shumë që munden, duke iu mundësuar së pari rezidentëve t’i njohin elementet më të rëndësishëm të identitetit të një kombi, si dhe gjatë kryerjes së angazhimeve të përditshme duke përdorur pikërisht këtë rrugëkalim. Kështu, detajet kryesore (veprat e artit brenda ndërtesës) kur kombinohen së bashku, haptazi përfaqësojnë kombin të orientuar drejt një mjedisi të qëndrueshëm dhe një arkitekture miqësore pa lënë mënjanë respektin maksimal për traditën e ndërtimit vendas ose më mirë rregulloret e dizajnit.

¹⁸ “River – Riviere – Fluss”, vepër e artit projektuar nga Barbara Steinman, artiste e shpërblyer me Çmimin e Guvernatorit të Përgjithshëm në artet Pamore dhe Mediale në 2002. Tregon hartën e thellësise së ujit dhe sugjeron një mbishtresë të vendeve: Kanadaja brenda Berlinit(Gjermani), secili i njohur për ujërat e shumta dhe lumenjeve. http://www.canadainternational.gc.ca/germany-allemanne/offices-bureaux/embassy_art_ambassade.aspx?lang=eng



(25)



(26)

Përfundim

Siç është elaboruar më lart, të gjitha këto struktura pa asnjë dyshim përfaqësojnë një shtet, vend ose rajon në kontekstin e arkitekturës, por mund të dallohet mjaft qartë se këto struktura kalojnë në drejtime të ndryshme ose më mirë të themi se mundohen të shprehin botëkuptime të ndryshme se si duhet të përfaqësohen konkretisht në këtë mjedis dhe çfarë përbën (kombi) interes më të madh për ta. Katër çështjet/ pyetjet e formuluar më lart rezultuan si:

- Kriza e identitetit- e cila si kryefjalë pati përdorimin e elementeve të sigurisë së lartë, dhe ideja për të krijuar fortesa apo fortifikime të përkohshme
- Identiteti kolektiv- nënkupton transparencën e strukturës e cila shërben jo vetëm si ambasadë por edhe si ndërtesë muze udhërrëfyese, kjo si rezultat i kontributit të arkitektit të famshëm dhe grupit të dizajnit

- Identiteti i një rajoni-komplekset kur shihen nga lart duan të simbolizojnë rajonin në hartë pa lënë pas materialet më të rëndësishme dhe stilin e përdorur në “shtëpi”
- Kujdesi ndaj Mjedisit-elementi më i rëndësishëm i epokës sonë është dizajni i qëndrueshëm dhe arkitektura ekologjike, dizajni për ruajtjen e energjisë maksimale gjithmonë ka treguar kujdes për mjedisin ekzistues (natyror dhe njerëzor)

Bibliografi:

Fazio, Michael. Moffet, Marian. Wodehouse, Lawrence. *A World History of Architecture*, Second Edition. London: Laurence King Publishing, 2008.

Glancey, Jonathan. “The Architecture of Diplomacy”, *The Guardian*, 09/01/20019.

Verlag, Michael Imhof. *Berlin – New Architecture – A guide to new buildings from 1989 to today*, 8th updated edition. Taschen, 2008.

Koolhaas, Rem. Chaslin, Francois. *The Dutch Embassy in Berlin by OMA/ Rem Koolhaas*. Rotterdam: NAI Publishers, 2004.

Phillips, Duane. Geyer, Alexandra. *Berlin – A guide to recent architecture*. London: Anova books Company, 2003.

Tschumi, Bernard. Cheng, Irene. *The State of Architecture at the beginning of the 21st Century*. Columbia Books of Architecture, 2003.

Weller, Christoph. *Collective Identities in World Society Some Theoretical and Conceptual Considerations*. World Society Research Group, June 1997.

Burimet nga Interneti:

<http://www.buildings.com/article-details/articleid/5784/title/global-diplomacy-and-design-security-at-u-s-embassies.aspx> (parë për herë të fundit me 10/04/2009)

http://www.canadainternational.gc.ca/germany-allemagne/offices-bureaux/embassy_art_ambassade.aspx?lang=eng (parë për herë të fundit me 20/04/2009)

<http://germany.usembassy.gov/germany/sp20040506.html> (parë për herë të fundit me 03/05/2009)

<http://www.sollewittprints.org/biography> (parë për herë të fundit me 10/05/2009)

<http://www.theguardian.com/artanddesign/2009/jan/09/embassy-iraq-us-architecture> (parë për herë të fundit me 15/05/2009)

Figurat/Fotografisë:

(Fig. 1) – Axel Mauruszat

(Fig. 2-3-4-5-6-7-8-9-10-27) – Moore Ruble Yudell Architects with Gruen Associates:

(Fig. 11-12-13-14-15-28) - //en.wikiarquitectura.com

(Fig. 16-17-18-20-29) - Berger + Parkkinen architekten: //arcspace.com

(Fig. 19) - Christian Richters: //arcspace.com

(Fig. 21-22-23-24-30) - fotodesignberlin: //international.gc.ca

(Fig. 25-26) - Viscusi, Stones & Projects Ltd., Berlin: //international.gc.ca